



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15918 Prot

Lezhë, më 26 / 09 /2022

VENDIM

Nr. 105, Datë 23 . 09 .2022

**Për disa ndryshime në VKB nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024”.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**Vendosi :**

**1.Miratimin e disa ndryshimeve të vendimit KB nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024”, si më poshtë:**

**1/1-Në pikën 1/b “Plani shpenzimeve sipas programeve buxhetore” për vitin 2022 bëhen këto ndryshime:**

• Pakësohen shpenzimet në programet buxhetore, konkretisht në:

-Gr.00, Prog.01110, Kap.05, Art.602 në shumën 2,200,000 lekë, në zërat: dhurata e pritje zyrtare me vlerë 500,000 lekë, leje mjedisore me vlerë 1,000,000 lekë, aktivitete sociale me vlerë 200,000 lekë dhe kuota anëtarësie me vlerë 500,000 lekë.

-Gr.00, Prog.01110, Kap.05, Art.231 në shumën 17,997,000 lekë, për objektet: blerje pajisje kompjuterike me vlerë 1,800,000 lekë, blerje pajisje zyrash me vlerë 13,000,000 lekë, F/V kamera me vlerë 300,000 lekë, blerje mikrofona për sallën e këshillit me vlerë 297,000 lekë dhe rikonstruksion i zyrave të Njësive Administrative Balldre, Zejmen e Kolsh me vlerë 2,600,000 lekë.

-Gr.00, Prog.01120, Kap.05, Art.602 në shumën 594,000 lekë, në zërat: shpenzime për barrë hipotekore me vlerë 120,000 lekë dhe shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit të taksave me vlerë 474,000 lekë.

-Gr.00, Prog.01120, Kap.05, Art.231 në shumën 180,000 lekë, blerje pajisje kompjuterike.

-Gr.00, Prog.03140, Kap.05, Art.602 në shumën 300,000 lekë, në zërin: blerje uniforma policie me vlerë 300,000 lekë.

-Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art.602 në shumën 10,998,000 lekë, në zërat: blerje uniforma e emblema me vlerë 260,000 lekë, fond emergjence me vlerë 10,000,000 lekë, blerje uniforma dhe vegla pune me vlerë 220,000 lekë dhe blerje pajisje teknike me vlerë 518,000 lekë.

- Gr.00, Prog.03600, Kap.05, Art.602 në shumën 158,000 lekë, në zërat: takime konsultative me publikun me vlerë 73,000 lekë dhe takime informuese me të rinjtë me vlerë 85,000 lekë.
- Gr.00, Prog.04130, Kap.05, Art.602 në shumën 120,000 lekë, në zërin: takime informuese me biznesin me vlerë 120,000 lekë.
- Gr.00, Prog.04220, Kap.05, Art.602 në shumën 38,500 lekë, në zërin; shpenzime për mbajtjen nën kontroll të qenve dhe maceve endacake me vlerë 38,500 lekë.
- Gr.00, Prog.04260, Kap.05, Art.231 në shumën 1,500,000 lekë, për objektin “Ndërtim prita malore në fshatin Markatomaj” me vlerë 1,500,000 lekë.
- Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.602 në shumën 180,000 lekë, në zërin; shpenzime mirëmbajtje dhe blerje bileta për traun elektronik me vlerë 180,000 lekë.
- Gr.00, Prog.04760, Kap.05, Art.231 në shumën 200,000 lekë, për objektin: “Blerje droni” me vlerë 200,000 lekë.
- Gr.00, Prog.05100, Kap.01, Art.602 në shumën 1,000,000 lekë, në zërin; blerje doreza e materiale për pastrimin me vlerë 1,000,000 lekë.
- Gr.00, Prog.05100, Kap.05, Art.602 në shumën 300,000 lekë, në zërin; blerje uniforma pune me vlerë 300,000 lekë.
- Gr.00, Prog.05100, Kap.05, Art.231 në shumën 100,000 lekë, për objektin “ Blerje 4 biçikleta” me vlerë 100,000 lekë.
- Gr.00, Prog.05200, Kap.05, Art.602 në shumën 650,000 lekë, në zërin; blerje uniforma pune me vlerë 650,000 lekë.
- Gr.00, Prog.06260, Kap.05, Art.602 në shumën 2,340,000 lekë, në zërat; blerje uniforma pune me vlerë 220,000 lekë, shërbime varrezash me vlerë 1,000,000 lekë dhe blerje materiale për varrezat me vlerë 1,120,000 lekë.
- Gr.00, Prog.06260, Kap.05, Art.231 në shumën 2,100,000 lekë, për objektet; “Rehabilitim i varrezave të qytetit në fshatin Gocaj me vlerë 1,500,000 lekë dhe “Rrethim i varrezave Mabë” me vlerë 600,000 lekë.
- Gr.00, Prog.08220, Kap.05, Art.231 për shumën 3,000,000 lekë, për objektin; “F/V të Bustit të Gent Demalisë” me vlerë 3,000,000 lekë.
- Gr.00, Prog.09120, Kap.05, Art.602 në shumën 379,644 lekë, në zërin: blerje dru zjarri me vlerë 379,644 lekë.
- Gr.00, Prog.09120, Kap.05, Art.231 në shumën 1,500,000 lekë, për objektet: “Rikonstruksion i Kopshtit Mërqij” me vlerë 1,000,000 lekë dhe “Rikonstruksion i Kopshtit Kalivaç” me vlerë 500,000 lekë.
- Gr.00, Prog.09230, Kap.05, Art.602 në shumën 549,000 lekë, në zërat: aktivitete për ditën e rinisë me vlerë 50,000 lekë, fushatë sensibilizuese për mjedisin me vlerë 50,000 lekë, fuqizim i komunitetit rinor me vlerë 39,000 lekë, konkurs debat me të rinjtë me vlerë 200,000 lekë, nxitja e vullnetarizmit me vlerë 60,000 lekë dhe kampi veror për të rinjtë me vlerë 150,000 lekë.
- Gr.00, Prog.09230, Kap.05, Art.231 në shumën 2,000,000 lekë, për objektin: “F/V kaldajash në Sh. M.Bashkuar Gjadër dhe Gjimnazin Lezhë” me vlerë 2,000,000 lekë.
- Gr.00, Prog.10430, Kap.05, Art.602 në shumën 600,000 lekë, në zërin: honorare për strehëzën emergjente për gratë dhe vajzat e dhunuara me vlerë 600,000 lekë.

• Shtohet shpenzimet në programet buxhetore, konkretisht në :

- Gr.00, Prog.01100, Kap.01, Art.602 për shumën 1,000,000 lekë (En.El.detyrim i prapambetur).
- Gr.00, Prog.01100, Kap.05, Art.602 për shumën 1,934,903 lekë (En.El.detyrim i prapambetur).
- Gr.00, Prog.06440, Kap.05, Art.602 për shumën 5,684,725 lekë (En.El.detyrim i prapambetur).

- Gr.00, Prog.03140, Kap.05, Art.602 për shumën 139,800 lekë (Karburant).
- Gr.00, Prog.04240, Kap.05, Art.602 për shumën 3,495,000 lekë (Karburant).
- Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.602 për shumën 5,285,600 lekë (Karburant).
- Gr.00, Prog.06140, Kap.05, Art.602 për shumën 244,650 lekë (Karburant).
- Gr.00, Prog.08220, Kap.05, Art.602 për shumën 34,950 lekë (Karburant).
- Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.231 për shumën 9,171,000 lekë për objektin: “Rehabilitim i Shëtitores dhe Lulishtes në lumin Drin”, (punime ndërtimi me vlerë 5,700,000 lekë dhe supervizim punimesh me vlerë 3,471,000 lekë).
- Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.231 për shumën 7,468,316 lekë për objektin: “Infrastrukturë e re për rrugët turistike në Plazhin e Tales, Njësia Ad.Shënkoll”, (punime ndërtimi me vlerë 4,700,000 lekë dhe supervizim punimesh me vlerë 2,768,316 lekë).
- Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.231 për shumën 14,525,200 lekë për objektin: “Trotuari i Ri në lagjen \*Xhenjo\*”, (punime ndërtimi me vlerë 13,930,000 lekë, supervizim punimesh me vlerë 446,400 lekë dhe kolaudim punimesh me vlerë 148,800 lekë).

1/2 -Në pikën 1/c “Prioritetet e investimeve për vitet 2022-2024” bëhen këto ndryshime:

- Hiqen këto prioritete për investime dhe fondet përkatëse:

- Sistemim dhe asfaltim rrugë urbane në qytetin Lezhë me vlerë 97,577,187 lekë, respektivisht për vitin 2023 – 31,125,849 lekë dhe për vitin 2024 – 66,451,338 lekë.

- Ndërtimi i Terminalit të Autobuzëve në qytetin Lezhë me vlerë 100,000,000 lekë për vitin 2023.

- Shtohen këto prioritete për investime dhe fondet përkatëse:

- Rehabilitim i Shëtitores dhe Lulishtes në lumin Drin me vlerë totale 119,171,001 lekë, respektivisht për vitin 2022 – 9,171,000 lekë (punime ndërtimi 5,700,000 lekë-supervizim 3,471,000 lekë), për vitin 2023 – 71,312,925 lekë dhe për vitin 2024 – 36,687,076 lekë.

- Infrastrukturë e re për rrugët turistike në Plazhin e Tales me vlerë totale 95,045,502 lekë, respektivisht për vitin 2022 – 7,468,316 lekë (punime ndërtimi me vlerë 4,700,000 lekë dhe supervizim me vlerë 2,768,316 lekë), për vitin 2023 – me vlerë 59,812,924 lekë dhe për vitin 2024 – me vlerë 27,764,262 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI  
NDUE LULI





KB  
Prot. 15919/  
Dt. 29.5.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 6745 Prot.

Lezhë, më 28.09.2022

L e n d a : Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 105, datë 23.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për disa ndryshime në VKB nr. 177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024”.

**PREFEKTI**

**Gjergj PRENDI**

